

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ), Korrik 2023

23.08.2023


Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin korrik 2023.

Deficit tregtar është më i lartë për 4,4% në muajin korrik 2023, krahasuar me korrikun 2022

Të dhënat nga Tregtia e Jashtme e Mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 4,4% në muajin korrik 2023, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2022, gjegjësisht në vlerë prej 444,7 milion euro, krahasuar me deficitin prej 426,1 milion euro në vitin 2022. Eksporti mbulon importin me 13,1%.


Eksporti i mallrave në muajin korrik 2023 kishte vlerën 67,3 milion euro, ndërsa importi 512,0 milion euro, që është një rënie prej (-11,8%) për eksport, si dhe një rritje prej 1,9% për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Grafikomi në vijim paraqet qarkullimi e mallrave në tregtinë e jashtme




Sipas të dhënave të grupeve kryesor të eksportit e përbëjnë: (22.2%) metalet bazë dhe artikujt prej tyre, (17.5%) artikuj të ndryshëm të prodhuar, (14.5%) plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre, (10.6%) ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, (6.3%) produkte bimore, (5.2%) tekstil dhe artikuj tekstili, etj.

Eksportet sipas sektorëve të grupeve kryesore në vlerë



Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 14,7% e përbëjnë produktet minerale; 12,9% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 11,7% e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 11,1% e përbëjnë mjetet e transportit; 9,4% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 6,7% e përbëjnë produktet e industrisë kimike; 5,7% e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre, etj.

Importet sipas sektorëve të grupeve kryesore në vlerë



Eksportet dhe importet sipas vendeve në vlerë dhe në (%)

(në mijë Euro)

Vendet	Korrik- 2022		Korrik - 2023	
	Vlera	%	Vlera	%
	Eksportet (FOB)			
Gjithsej	76,298	100.0	67,320	100.0
27 vendet e BE_së	26,430	34.6	22,132	32.9
Cefta	25,845	33.9	27,612	41.0
Të tjera	24,023	31.5	17,576	26.1
Importet (CIF)				
Gjithsej	502,414	100.0	512,055	100.0
27 vendet e BE_së	210,980	42.0	224,447	43.8
Cefta	88,462	17.6	73,991	14.4
Të tjera	202,972	40.4	213,617	41.7

Eksportet dhe importet e Kosovës me vendet e BE-së

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 22,1 milion euro, ose rreth 32,9% të eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej (-16,3%). Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (11,2%), Italia (5,1%), Holanda (3,1%), etj.

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 224,4 milion euro, ose 43,8% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 6,4%. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (13,5%), Italia (6,0%), Greqia (4,8%), etj.

Eksportet dhe importet e Kosovës me vendet e CEFTA-s

Eksportet e Kosovës me vendet CEFTA-s arritën në 27,6 milion euro, ose 41,0% të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 6,8%. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Shqipëria (14,3%), Maqedonia e Veriut (13,3%), Mali i Zi (6,0%), Serbia (5,5%).

Ndërsa, importet nga vendet e CEFTA-s në muajin korrik 2023, arritën në 73,9 milion euro, ose 14,4% të importeve të përgjithshme, me një rënie prej (-16,4%). Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Maqedonia e Veriut (5,9%), Shqipëria (5,4%), Serbia (1,3%).

Eksportet dhe importet e Kosovës me vendet e tjera të botës

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 17,5 milion euro, ose 26,1%. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmenden: SHBA (11,7%) dhe Zvicra (8,7%).

Ndërsa importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 213,6 milion euro, ose 41,7%. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Kina (12,8%) dhe Turqia (11,6%).

Për më shumë informata, lidhur me Statistikat e Tregtisë së Jashtme për muajin korrik 2023, vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/Themes/ForeignTrade>